

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6574
E premte, 1 prill 2022
çmimi 0.40 €

Përkujtohen 106 civilët
e vrarë nga forcat serbe
në fshatin Pastasellë | F. 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NAFTA LIROHET NË BOTË, SHTRENJTOHET NË KOSOVË



Çmimi i derivateve të naftës në tregun e Kosovës sërish ka shënuar rritje ani pse në bursën ndërkombëtare ka shënuar ulje. Në Kosovë, më 31 mars, një litër naftë është shitur në 1.69 euro centë, ndërsa benzina 1.59 euro centë, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni. Përfaqësues të naftëtarëve çmimin e arsyejnë për shkak se importi i këtij produkti nga kompanitë tregtare dhe furnizuese është blerë më herët me çmim më të lartë

AKTUALE



**ZELENSKY THOTË SE LUFTA ËSHTË
"NË PIKË KTHESE" | F. 2**

PD-ja ME TRE "KRYETARË" | F. 3

**HARADINAJ VIZITON SHOQATAT E
DALA NGA LUFTA: KATEGORITË E
LIRISË JANË TESTAMENTI YNË | F. 3**

**XHAFER GASHI ZGJEDHET KRYETAR
I DEGËS SË LDK-së OBILIQ | F. 6**

EKONOMI



**MIRATOHET BUXHETI PËR SHTATË
KOMUNAT E KOSOVËS | F. 8**

**EKONOMIA SHQIPTARE, 8.54 PËR
QIND RITJE NË VITIN 2021 | F. 8**

SPORT



**SONTE DRITA - PRIZRENI 16, NESËR
DERBI PRISHTINA - YLLI | F. 10**

**PSD-ja e shpall Kurtin
'veteran të rrejshëm'** | F. 5



**SHBA-ja E NDIHMON KOSOVËN
EDHE ME 32 MILIONË DOLLARË** | F. 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia shpall armëpushimin në Mariupol

MOSKË, 31 MARS - Ministria ruse e Mbrojtjes ka njoftuar për një armëpushim në qytetin e rrethuar të Mariupolit në Ukrainë, duke filluar nga mëngjesi i së enjtes, për të lejuar evakuimin e civilëve. "Që ky operacion humanitar të ketë sukses, ne propozojmë që të kryhet me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatë dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq", tha ministria në një deklaratë të cituar nga AFP-ja.

Korridori humanitar nga Mariupoli në Zaporizhia - përmes qytetit Berdiansk që kontrollohet nga Rusia - do të hapet mëngjesin e së enjtes. Autoritetet e Ukrainës nuk e kanë komentuar ende këtë njoftim.

Përpjekjet e mëparshme për të vendosur një armëpushim në Mariupol kanë dështuar, mes akuzave për sulme nga të dyja palët.


Rusia është akuzuar, gjithashtu, se ka zhvendosur me forcë mijëra civilë në Rusi ose në zonat e kontrolluara nga Rusia.

Njoftimi u bë pasi fotot e reja

ruse po grumbullohen në përgatitjen e një sulmi të ri në rajonin lindor të Donbasit në Ukrainë.

Rusia tha se do t'i kufizonte operacionet pranë kryeqytetit, Kiev, dhe qytetit verior të Çernihivit "për ta rritur besimin e ndërsjellë" për bisedimet e paqes, pasi të dyja palët u takuan ballë për ballë në Stamboll më 29 mars. Bisedimet pritet të rifillojnë sot përmes videolidhjes, tha negociatori ukrainas David Arakhamia. "Ne nuk i besojmë askujt, asnjë fraze të bukur", tha Zelensky në një fjalim me video më 30 mars, duke shtuar se ai beson se trupat ruse po rigrupohen për ta goditur rajonin lindor të Donbasit. "Ne nuk do të heqim dorë nga asgjë. Ne do të luftojmë për çdo metër të tokës sonë, për çdo person", tha Zelensky, duke përsëritur thirrjen e tij për ndihmë ushtarake perëndimore.

"Nëse me të vërtetë po luftojmë për lirinë dhe mbrojtjen e demokracisë, atëherë kemi të drejtë të kërkojmë ndihmë në këtë pikë kthese të vështirë.



tij dhe krerëve ushtarakë. "Ne besojmë se Putini është duke u keqinformuar nga këshilltarët e tij rreth asaj se sa dobët është duke vepruar ushtria ruse dhe si është duke u dëmtuar ekonomia ruse nga sanksionet, sepse këshilltarët e lartë ushtarakë janë

kolonë prej 45 autobusësh është nisur drejt qytetit të rrethuar të Mariupolit në përpjekje për t'ie evakuuar civilët e bllokuar nga luftimet e ashpra midis trupave ruse dhe atyre ukrainase. "Ne morëm një mesazh nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, se Federata Ruse konfirmon gatishmërinë e saj për ta hapur korridorin humanitar në qytetin e Mariupolit përmes qytetit Berdiansk", tha ajo në një video të postuar në "Telegram". "Ne po dërgojmë 45 autobusë në korridorin e Mariupolit", shtoi ajo.

Kryqi i Kuq tha se po përgatitej ta lehtësonte kalimin e sigurt të civilëve nga Mariupoli të premtën, nëse të gjitha palët pajtohen me kushtet. "Është

jashtëzakonisht e rëndësishme që ky operacion të zhvillohet. Jetët e dhjetëra mijëra njerëzve në Mariupol varen prej këtij operacioni", tha përmes një deklaratë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Zyrtarët ushtarakë rusë kanë thënë se janë të gatshëm t'i përmbahen një armëpushimi për ta lejuar hapjen e një korridori humanitar.

Qyteti me rreth 430 000 banorë para fillimit të luftës është përballur me luftime intensive për javë të tëra ndërmjet forcave ruse dhe atyre ukrainase.

Sulmet ruse kanë goditur një maternitet, objektet kulturore dhe shtëpitë e civilëve.

Dhjetëra mijëra civilë thuhet se janë bllokuar në qytet pa energji elektrike dhe pa ushqim dhe ujë.



satelitore treguan shkatërrimin e shkatëruar nga granatimet.

Imazhet e publikuara nga kompania e vëzhgimit të Tokës, Maxar, treguan se zonat e banuara janë kthyer në gërmadha. Këto imazhe kanë vënë në pah topat e artilerisë ruse në pozicionet e qitjes në periferi të qytetit.

Zelensky thotë se lufta është "në pikë kthese"

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha se ushtria e tij po përgatitet për luftime të mëtejshme në lindje dhe i quajti "frazë të bukura" premtimet ruse për ta zvogëluar aktivitetin ushtarak. Zelensky paralajmëroi se forcat

Tanke, avionë, sisteme artilerie. Liria nuk duhet të armatohet më keq se tirania", tha Zelensky. Zelensky dhe presidenti amerikan Joe Biden gjatë një telefonate njëorëshe diskutuan për mbështetjen specifike mbrojtëse, për një paketë të sanksionesh kundër Rusisë dhe për ndihmën financiare dhe humanitare.

Shtëpia e Bardhë: Putini ndihet i mashtruar nga këshilltarët ushtarakë

Shtëpia e Bardhë ka thënë se ka inteligjencë që presidenti rus Vladimir Putin ndihet se është mashtruar nga këshilltarët ushtarakë, çka ka rezultuar me tension të vazhdueshëm në mes

shumë të frikësuar për ta treguar të vërtetën", ka thënë drejtoresha për Komunikime e Shtëpisë së Bardhë, Kate Bedingfield, në një prononcim para gazetarëve. Ajo ka thënë se "është e qartë" që pushtimi rus në Ukrainë ka qenë "gabim strategjik" që do ta lë atë të dobët në periudhë afatgjatë. Bedingfield ka thënë, po ashtu, se Shtetet e Bashkuara "vazhdojnë të shohin të dhëna për sulmet ruse dhe avancim në vendet që Rusia ka thënë se nuk do të luftojë".

Autobusët shkojnë në Mariupol për t'i ndihmuar civilët

Zëvendëskryeministrja ukrainase Iryna Vereshchuk tha se një



ShBA-ja e ndihmon Kosovën edhe me 32 milionë dollarë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, bashkë me Zeinah Salahi, drejtoreshë e USAID-it në Kosovë dhe në prani të ambasadorit të Shteteve të Bashkuara, Jeffrey M. Hovenier, ka nënshkruar të enjten amendamentin e katërt të Grantit për Objektivat Zhvillimore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Amendamenti parasheh fitimin shtesë të 31,994,644 dollarëve, duke e rritur totalin e grantit mbi 73.4 milionë dollarë. "Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara në Kosovë është dëshmi e përkushtimit të qeverisë dhe popullit amerikan për ta përfunduar mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes institucioneve efektive dhe llogaridhënëse, si dhe rritjes së mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike", ka thënë presidentja Osmani.

Me këtë marrëveshje synohet shërbimi më i mirë ndaj qytetarëve nga institucionet llogaridhënëse dhe efektive të qeverisjes, si dhe rritja e mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike. Gjithashtu, me të synohet përmirësimi dhe bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve, shoqërisë civile, bizneseve dhe sektorit publik në mënyrë që komunitetet lokale të kenë pozicion më të favorshëm për t'i adresuar sfidat zhvillimore të Kosovës.

Këtë ndihmë të ShBA-së ish-kryeministri Ramush Haradinaj e ka quajtur lajm fantastik. "Lajm fantastik shuma prej 32 milionë dollarësh i grantit për objektiva zhvillimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Do të isha shumë i lumtur sikur sot njoftimi të ishte se Kosova përfiton 232 milionë dollarë, duke përfshirë këtu edhe ato 200 milionë për gazsjellësin. Taksapaguesve amerikanë, faleminderit! Qeverisë, kthjellu!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



PD-ja me tre "kryetarë"

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 31 MARS - Lulzim Basha, në një deklaratë për medie, ka thënë të enjten se ai ka bërë dhe do të bëjë gjithçka për vlerat e bashkuara në Partinë Demokratike. Ai ka theksuar se një nga parimet kryesore është orientimi euroatlantik. "Unë e kam të qartë rrugën që duhet ta përshkruajë PD-në për ta kthyer në një alternativë për njerëzit dhe do të punoj përsosht për këtë rrugë. Ujërat mund të jenë të turbullta, por ato do të qartësohen", ka thënë Basha.

Për zhvillimet në PD ka folur edhe Sali Berisha. Ai u është përgjigjur pyetjeve të gazetarëve për ndryshimet që po bëhen në objektin e PD-së.

Berisha ka thënë se nuk e di se me çfarë financash po bëhen këto punime në Partinë Demokratike, por ka paralajmëruar se do të ketë një



zyrë të vetën në selinë blu dhe shtoi se aktualisht kjo parti nuk ka një kryetar. "Nuk kam asnjë dijeni, por do të kërkoj që të

bëhet transparencë. Nuk e di nëse janë me financat e partisë, por si është gjendja e arkës në këtë parti, nuk e kam idenë. Zyra

ime do të jetë një zyrë midis këtyre zyrave. Nuk ka zyrë kryetari. Nuk ka kryetar", u shpreh Berisha.

Të enjten kryetari në detyrë i PD-së, Enkelejd Alibeajt, ka thirrur mbledhjen e grupit parlamentar të partisë, ku munguan tetë deputetë, mes të cilëve edhe Lulzim Basha. Por në këtë mbledhje mori pjesë edhe Sali Berisha, ku pati një përplasje me kryetarin në detyrë të PD-së, Enkelejd Alibeajt.

Berisha e cilëson 'nul' përjashtimin nga grupi parlamentar, ndërsa Alibeaj nënvizoi se duhet të tërhiqet Berisha që të bashkohen demokratët.

PD-ja ka mbetur pa kryetar pas dorëheqjes së Bashës, ku edhe janë paralajmëruar zgjedhjet e reja të brendshme. Sali Berisha ka konfirmuar kandidimin për kryetar partie, ndërsa Basha ende nuk e ka konfirmuar një gjë të tillë, por është duke vazhduar takimet me anëtarët e PD-së.

Kryetar në detyrë i PD-së deri në zgjedhjen e liderit të ri është Enkelejd Alibeaj.

Haxhiu vizitoi të paraburgosurit në Hagë, Thaçi dhe Veseli nuk pranuan takim

HAGË, 31 MARS (ER) - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar disa nga ish-udhëheqësit e UÇK-së të cilët po mbahen në paraburgim në Hagë në Dhomat e Specializuara. Haxhiu ka takuar Hysni Gucatin, Pjetër Shalën, Rexhep Selimin, Jakup Krasniqin dhe Nasim Haradinajn. Kështu ka njoftuar deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi.

"Së bashku me nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe deputetin Erxhan Galushi, gjatë vizitës Dhomave të Specializuara, dje takuam Hysni Gucatin, Pjetër Shalën dhe Rexhep Selimin, kurse sot Jakup Krasniqin dhe Nasim Haradinajn. Ishte vizitë institucionale dhe e

rëndësishme. Në këto takime u njoftuam për së afërmi me kërkesat, trajtimin dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me gjykatën", ka shkruar Rrustemi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministria Haxhiu nuk e ka takuar ish-presidentin Hashim Thaçi, as ish-kreun e PDK-së, Kadri Veseli, pasi ata nuk kanë pranuar një takim me ministren.





Nafta lirohet në botë, shtrenjtohet në Kosovë

Çmimi i derivateve të naftës në tregun e Kosovës sërisht ka shënuar rritje, pavarësisht se në bursën ndërkombëtare ka shënuar ulje. Në Kosovë, më 31 mars, një litër naftë është shitur deri në 1.69 euro centë, ndërkaq benzina deri në 1.59 euro centë, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni. Përfaqësues të naftëtarëve çmimin e arsyetojnë për shkak se importi i këtij produkti nga kompanitë tregtare dhe furnizuese është blerë më herët, me çmim më të lartë

PRISHTINE, 31 MARS - Çmimi i derivateve të naftës në tregun e Kosovës sërisht ka shënuar rritje pavarësisht se në bursën ndërkombëtare ka shënuar ulje. Përfaqësues të naftëtarëve çmimin e arsyetojnë për shkak se importi i këtij produkti nga kompanitë tregtare dhe furnizuese është blerë më herët me çmim më të lartë. Në Kosovë, më 31 mars, një litër naftë është shitur deri në 1.69 euro centë, ndërkaq benzina deri në 1.59 euro centë, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni. Çmimi i këtij produkti disa ditë kishte shënuar rënie deri në 1.49 euro centë. Me çmimet aktuale këto produkte janë shitur edhe më 8 mars, kur nafta e përpunuar në bursën ndërkombëtare ka qenë 130 dollarë për fuqi. Mirëpo, nafta e papërpunuar Brent, e cila përdoret si pikë ndërkombëtare e referimit, më 31 mars ka rënë në rreth 106 dollarë për fuqi. Ministria e

Industrië,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) të mërkurën ka thënë se sinkronizimi i rritjes së çmimeve të naftës lë hapësirë për dyshim në orkestrim të rritjes së çmimit. Ata kanë shtuar se autoritetet po inspektojnë në terren. "Radio Evropa e Lirë" ka kërkuar të enjten përgjigje nga MINT-i se cilat janë gjetjet nga inspektimi në terren, por deri në momentin e publikimit të tekstit nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje. Lëvizjet e çmimeve të karburanteve po ndodhin për shkak të rritjes së kërkesës për këtë produkt në tregjet ndërkombëtare pas ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Ukrainë dhe sanksioneve që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Bashkimit Evropian kanë vendosur kundër Moskës. Irfan Gërguri, pronar i kompanisë "Gërguri Petrol" nga Fushë-Kosova, që merret me shitjen me pakicë të karburanteve, pranon se të mërkurën (30 mars) ka rritur çmimin e karburanteve nga 1.60

në 1.65 euro centë, edhe pse ka pasur rezerva, "pasi që çmimi është rritur edhe nga kompanitë e tjera". Ai shton se nuk varet nga çmimi i bursës ndërkombëtare, por nga çmimi me të cilin blen në kompanitë brenda Kosovës. "Kompanitë e mëdha i shikojnë vetëm interesat e veta. Ne jemi duke punuar me humbje. Para katër ditësh jam furnizuar me naftë me 1.59 euro centë. Deri më 29 mars me pakicë e kam shitur 1.60 euro centë, kurse nga e mërkura e kam ngritur çmimin në 1.65 euro centë. Nga dje jemi më mirë, fitojmë 0.6 centë në ditë. Benzinën e kam blerë 1.46 euro centë dhe deri dje e kam shitur nga 1.40 euro centë, me katër centë në humbje. Tash është 1.50 euro centë. Që dy ditë jemi më mirë", ka theksuar ai. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar disa nga kompanitë që merren me tregtim dhe furnizim me shitje me shumicë të

karburanteve në Kosovë, por ato nuk kanë dhënë përgjigje se me çfarë çmimi janë furnizuar. Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se çmimet aktuale në treg janë rritur për shkak se importi i produktit ka ndodhur më herët dhe tashmë ka dalë në shitje. "Çmimi i karburanteve me shumicë - më 31 mars, një litër naftë ka kushtuar 1.55 euro centë, shto këtu edhe marzhën e qeverisë. Kështu që çmimi i një litre naftë në treg del 1.69 euro centë", ka thënë Berjani. Qeveria e Kosovës më 1 mars ka marrë vendim që t'i përcaktojë çmimet shitëse maksimale apo marzhat tregtare me shumicë. Sipas këtij vendimi, që ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve nga lëvizjet e mëdha të çmimeve, marzha më e lartë tregtare është 4 për qind e çmimit të shitjes, ndërkaq te shitësit me pakicë marzha më e lartë arrin deri në 6 për qind. Berjani shprehet se në lëvizjen e çmimeve ka ndikuar edhe ndërprerja e furnizimit për Kosovën nga disa kompani nga Shqipëria. Aktualisht vetëm një operator nga Shqipëria importon derivate në Kosovë, ajo është "Gega Oil Group".

Pronari i kësaj kompanie, Genc Gega, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", thotë se rezerva të derivateve ka mjaftueshëm, por kërkesa nga kompanitë e Kosovës ka rënë dukshëm për shkak të rritjes së çmimit. Ai tha se nga 4.2 milionë litra në ditë, sa ka qenë kërkesa më herët, tash kërkohen deri 200 mijë litra në ditë. "Nafta me shumicë për operatorët e Kosovës shitet për 1.53 euro", thotë Gega. Çmimi i naftës me pakicë në tregun e Shqipërisë është 1.95 euro, ndërsa çmimet më të lira të karburanteve janë në tregun e Maqedonisë së Veriut. Një litër naftë kushton 1.42 euro centë, kurse benzina 1.39 euro centë. Kosova nuk ka rafineri të saj dhe karburantet i importon nga vende të tjera. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vitin e kaluar në Kosovë janë importuar mbi 410 milionë litra naftë. Në këtë shifër nuk janë përfshirë derivatet e benzinës. Në periudhën nga 24 shkurti deri më 8 mars në Kosovë janë importuar rreth 31 milionë litra karburante, më së shumti nga Arabia Saudite, pastaj nga Maqedonia e Veriut, Greqia, Turqia e vende të tjera.

PSD-ja e shpall Kurtin “veteran të rrejshëm”

PRISHTINË, 31 MARS (ER) - Partia Socialdemokrate ka organizuar të enjten një aksion simbolik para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke e vënë një pankartë me mbishkrimin me të cilin e ka vlerësuar kryeministrin Albin Kurti si “veteran të rrejshëm” të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Ditëve të fundit ka nisur një fushatë e re prej anës së pushtetit për t’u marrë me listat e

veteranëve të UÇK-së. Diskursi i pushtetit na bënë të kuptojmë që veterani është barra financiare mbi kurrizin e Republikës së Kosovës nga e cila duhet të çlirohet vendi. Por, kur barra është pikënisja, mirëqenia nuk është përfundim. Po të ishte me të vërtetë i angazhuar pushteti që t’i verifikojë këto lista atëherë do ta dinte edhe procesin nëpërmjet të cilit do të bëhej kjo gjë. Çka, në

fakt, na mëson mungesa e procesit qëllimi i vërtetë i Kurtit që tash e ca kohë: denigrimi i veteranit të vërtetë. Edhe nëpërmjet atij të rrejshëm”, është theksuar në njoftimin e PSD-së. Sipas kësaj partie, Kurti është angazhuar në UÇK në gusht të vitit 1998 dhe ka dhënë dorëheqje prej saj më 2 mars 1999. “Por, le të merremi me veteranin e rrejshëm që sot gjendet në krye të qeverisë.

Kurti është angazhuar në UÇK në gusht të vitit 1998 dhe ka dhënë dorëheqje prej saj më 2 mars 1999. Siç edhe e parashihet ligji, veteranë është personi që ka qëndruar deri në fundin e luftës së UÇK-së. Ne e dimë që lufta ka përfunduar në qershor, pra 3 muaj pasi Kurti ka dhënë dorëheqje. Po i njëjti ligj definon dhe dënimin që dikush e merr në rast falsifikimit të deklaratës së

pjesëmarrjes në luftë. Ekzistojnë dëshmi materiale, me dokumente e deklarata, që tregojnë mashtrimin që Kurti ka bërë në mënyrë që të konsiderohet veteran i UÇK-së. Prokuroria duhet ta fillojë menjëherë hetimin e këtij rasti flagrant të falsifikimit. Nëse hetimi nuk fillon atëherë ne do të dorëzojmë kallëzim penal për këtë çështje”, ka njoftuar PSD-ja.



Haradinaj viziton shoqatat e dala nga lufta: Kategoritë e lirisë janë testamenti ynë

PRISHTINË, 31 MARS (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka takuar të enjten në selinë e OVL të UÇK-së kërret e shoqatave të dala nga lufta. Haradinaj ka thënë se kategoritë e lirisë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dëshmorët e të gjitha kohëve, invalidët, veteranët, familjet e martirëve, të pagjeturit, të burgosurit politikë e të persekutuarit, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, janë edhe dhembja edhe krenaria jonë. “Ata

janë testamenti ynë. Themeli ynë për të ardhmen”, ka deklaruar Haradinaj. Ish-kryeministri i vendit që gjatë luftës çlirimtare ishte komandant i Zonës Operative të Dukagjinit ka përmbyllur shkrimin e tij në “Facebook” duke thënë se: “E vërteta e kategorive të lirisë është e të gjithë neve. Ata që nuk janë të vërtetë nuk janë të asnjërit prej nesh. Por, të shfrytëzohen të pavërtetit për t’i turpëruar të vërtetit, është e papranueshme, është mallkim për brezat”.



Përkujtohet masakra e Burimit

MALISHEVË, 31 MARS (ER) - Nën organizimin e kryetarit të komunës së Malishevës sot është shënuar 23-vjetori i masakrës së Burimit. 23 vjet më parë forcat ushtarake dhe policore të Serbisë kryen masakrën më të madhe në komunën e Malishevës, e që njihet si masakra e Burimit, ku u vranë dhe më pas u masakruan 42 civilë, kryesisht nga fshatrat Astrazup dhe Dragobil, si dhe tre qytetarë të komunës së Suharekës, të cilët ishin të strehuar me familjet e tyre në fshatin Dragobil.

Për të përkujtuar këtë masakër është mbajtur një mbledhje përkujtimore në Asambleenë Komunale. Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, në një fjalë rasti të kësaj mbledhjeje

përkujtimore tha se “forcat ushtarake policore serbe në pamundësi që ta shpartallonin UÇK-në, në shumë fshatra dhe qytete të Kosovës, kryen një gjenocid të rëndë ndaj popullatës së pafajshme civile, dhe një ndër masakrat më të rënda që u kryen ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare ishte edhe masakra e Burimit, ku forcat serbe nuk u kursyen, duke bërë masakër në fëmijë, të moshuar, të hendikepuar e persona me nevoja të veçanta”.

Ai ka thënë se, fatkeqësisht, për këtë masakër deri më sot nuk është dënuar asnjë kryes i këtij krimi të rëndë dhe asnjë urdhërdhënës për vrasjen. “Familjarët kërkojnë drejtësi dhe

në funksion të kësaj, si kryetar i komunës së Malishevës do të jem në krye të përgjegjësisë, për t'i shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e duhur institucional, që të kërkojmë që rasti i masakrës së Burimit të ndriçohet dhe autorët e këtij krimi të dënohen”, ka thënë Kastrati.

Edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Argjend Thaçi, në fjalën e tij përkujtuase u shpreh se “në këtë përkujtim, pas 23 vjetëve, kujtojmë më të dashurit tanë dhe bashkëqytetarët, që me jetën dhe gjakun e tyre sollën lirinë e Kosovës, prandaj ju përulemi dhe i nderojmë përherë të rënë e kësaj masakre”, ka thënë ai. Në emër të familjeve të të rënëve ka folur Adem Morina.



Nura nderon dëshmorët dhe martirët e lagjes Gjinovci në fshatin Makërmal

SKENDERAJ, 31 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka nderuar në 23-vjetorin e rënies dëshmorët dhe martirët e lagjes Gjinovci në fshatin Makërmal si dhe anëtarët e familjes Rexhepi që u vranë po atë ditë. “Nderime të larta për dëshmorët dhe martirët e lagjes Gjinovci në fshatin Makërmal, si dhe anëtarë të familjes Rexhepi që u vranë po atë ditë, të cilët i përkujtojmë sot në 23-vjetorin e rënies së tyre, gjatë luftës së lavdishme çlirimtare për liri dhe pavarësi të vendit! Lavdi e përjetshme për trimat dëshmorë dhe martirët e Kosovës!”, ka shkruar Nura në llogarinë e vet në “Facebook”.

Komuna e Mitrovicës bëhet pjesë e programit të përbashkët të BE-së ‘CoE ROMACTED II’

Mitrovicë, 31 mars (ER) - Me ftesën e Këshillit të Evropës, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Mitrovicës, Valdete Idrizi, ka marrë pjesë në lansimin e programit të përbashkët të BE-së ‘CoE ROMACTED II’, i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë dhe fuqizimin e komuniteteve në nivel lokal. Gjatë këtij organizimi

drejtoresha Idrizi dhe shefi i zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Frank Power, kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për ta implementuar projektin nga programi i përbashkët i BE-së ‘CoE ROMACTED II’ në komunën e Mitrovicës e cila është përzgjedhur në mesin e dhjetë komunave të Kosovës.



Xhafer Gashi zgjedhet kryetar i Degës së LDK-së Obiliq

OBILIQ, 31 MARS (ER) - Delegatët e Kuvendit të Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Obiliq, pas një procesi demokratik dhe transparent, në prani të shumë qytetarëve të Obiliqit, zgjedhën me

unanimitet të plotë për kryetar të Degës Xhafer Gashin, kryetar aktual i komunës së Obiliqit. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka falënderuar të gjithë delegatët, aktivistët dhe strukturat e degës për përmbylljen e suksesshme

të këtij procesi. Po ashtu, kryetari Abdixhiku u shpreh i bindur se ky kuvend zgjedhor do të jetë model edhe për komunat e tjera, sipas mënyrës së angazhimit të anëtarëve, po ashtu, edhe në aspektin përmbytësor.



Përkujtohen 106 civilët e vrarë nga forcat serbe në fshatin Pastasellë

RAHOVEC, 31 MARS (ER) - Në fshatin Pastasellë të komunës së Rahovecit janë përkujtuar të enjten 106 civilët të vrarë, më pas edhe të masakruar, ndërsa një pjesë e tyre edhe të djegur. Kjo masakër është bërë më 31 mars të vitit 1999 nga forcat serbe. Në tubimin përkujtimor në shënimin e 23-vjetorit i pranishëm ka qenë edhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, përfaqësues të OVL-së, familjarë të të rënëve dhe qytetarë të fshatit Pastasellë dhe fshatrave

përreth. “Në ditën e fundit të marsit të përgjakur të vitit 1999 ndodhi një prej krimeve më mizore ngakriminelët serbë në fshatin Pastasel të Rahovecit, ku u vranë 106 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. Banorë të Pastaselit, por edhe të fshatrave përreth, Guri i Kuq, Zatriq, Polluzhë, Kaznik, Kramovik, Çifllak, Senoc dhe nga komuna e Klinës, kishin gjetur vendstrehim në fshat për ta shpëtuar veten dhe familjet e tyre nga krimet gjenocidiale serbe që kryheshin gjithandej

Rahovecit dhe Kosovës”, ka thënë Latifi, duke shtuar se ajo ditë e përgjakshme fundmarsi do të mbetet e pashlyer në kujtesën tonë për krimet e llahtarshme që përjetoi populli ynë gjatë përpjekjeve për çlirim. “Drejtësia dhe dënimi i krimeve të padënuara të 31 marsit 1999, do të jetë qëllimi ynë kryesor deri në realizim, për t’i qetësuar shpirtat e familjeve dhe popullit tonë për humbjet e mëdha njerëzore. Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve të luftës!”, ka thënë kryetari Latifi.



AAK-ja, qeverisë: Ku je fshehur? Ke mashtruar për Ligjin e Pagave

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 31 mars - Shefi i Grupit Parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie ka folur për Ligjin e Pagave, pagën minimale, tërheqjen e Trustit dhe ngritjen e çmimit të naftës. Tahiri ka thënë se Ligji i Pagave ka qenë pjesë e agjendës legislative të vitit 2021, dhe pjesë e agjendës për këtë vit dhe, mbi të gjitha, ka pasur zotim të qeverisë të ministrit të MPB-së, që në fund të marsit ky ligj të kalojë në qeveri. “Pyetja ime është ku është Ligji i Pagave, ku jeni fshehur me këtë ligj, ku është procesi i punës për finalizimin e këtij ligji. Pse keni thënë që ligji bëhet në mars, a ka qenë vetëm për t’i mashtruar shërbyesit civilë apo është pazotësi e juaja për të mos e miratuar këtë ligj?”, është shprehur Tahiri.



Ai ka theksuar se si AAK kanë parashtruar dy pyetje parlamentare për ministrin, po

ashtu kanë propozuar një amendament në Projektbuxhet për Ligjin e Pagave. “Kemi

kërkuar debat parlamentar ku është miratuar një rezolutë, ku Kuvendi kërkon nga qeveria që

ligji të vijë sa më shpejt. Është me rëndësi me qenë të sqartë, është e pafalshme për një qeveri që ka 50 për qind të fshihet prej kësaj pune. Qeveria është dashur t’u kërkojë falje shërbyesve civilë në këtë rast”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se të mërkurën është raportuar se ka rënie të çmimit të naftës për 80 dollarë, ndërsa në Kosovë ka vazhduar rritja e saj. “A u raportua dje që për 80 dollarë ka rënë çmimi i naftës. Po vazhdon të rritet çmimi. Pse nuk aktivizohet Autoriteti i Konkurrencës? A është mosdije apo ka të bëjë me ndonjë aferë korruptive”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se në mungesë të paaftësisë së qeverisë për lehtësimin e gjendjes së vështirë sociale që qytetarët po e përjetojnë, tërheqja e 30 për qind të Trustit është e drejtë që qytetarëve duhet t’i mundësohet.

Profesoresha Shqipe Bajçinca-Brestovci i bashkohet LDK-së



PRISHTINË, 31 MARS - Profesoresha e Edukimit Fizik dhe Sportit, Shqipe Bajçinca-Brestovci, është bërë pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Lajmin e ka dhënë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. “Shqipes i urova mirëseardhje dhe mbarësi në angazhimet e përbashkëta rreth politikave sportive që do t’i ndërtojmë e prezantojmë përpara. Përvoja e saj e jashtëzakonshme në sport, dija dhe kapacitetet e saj

profesionale do të jenë bazë e shëndoshë e programit të ardhshëm politik që LDK-ja ka nisur ta ndërtojë. Bashkimi i profesionistëve si profesoresha Bajçinca-Brestovci. Për ne është mundësi e shkëlqyeshme për t’i ofruar qytetarët tanë e të Kosovës, njerëz kredibilë e profesionistë të përkushtuar në secilën fushë. Kjo e sportit, me gjithë profesionistët e tjerë që i kemi tashmë, merr një vullë”, ka thënë Abdixhiku. Shqipe Bajçinca-Brestovci është

ligjëruese universitare në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Ajo ka një jetë të tërë kushtuar sportit, duke lënë gjurmë kulmore në fushën e hendbollit, atletikës dhe karatesë. Ajo është anëtare e Bordit Ekzekutiv në Komitetin Olimpik të Kosovës, anëtare e Bordit Ekzekutiv në Federatën e Hendbollit të Kosovës dhe delegate ndërkombëtare në Federatën Evropiane të Hendbollit (EHF).

Agjërimi i Ramazanit fillon të shtunën

PRISHTINË, 31 MARS (ER) - Bashkësia Islame e Kosovës i ka njoftuar qytetarët se agjërimi i Ramazanit fillon të shtunën më 2 prill 2022. Me rastin e fillimit të

muajit të bekuar të Ramazanit, kryesia e BI-së i ka përgëzuar besimtarët në Kosovë, diasporë e trojet tona duke u dëshiruar agjërime të lehtë, shtim të

ibadetit dhe solidaritet me njëri-tjetrin. Ramazani përfundon më 1 maj. Dita e parë e Fitër Bajramit do të jetë më 2 maj 2022.



Miratohet buxheti për shtatë komunat e Kosovës

PRISHTINË, 31 MARS - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka miratuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për aprovimin e kërkesës për miratimin e buxhetit për komunat Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë dhe Podujevë pas miratimit të tyre nga kuvendet komunale.

Këtë vendim e ka arsyetuar ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cili ka theksuar se këto komuna kanë respektuar kufijtë buxhetorë. "Këto komuna kanë pasur vonesa në miratimin e buxhetit të kuvendeve komunale siç parashihet me kornizën ligjore, andaj ligji parasheh që edhe pse ne tashmë kemi miratuar buxhetin në dhjetor të vitit të kaluar për vitin 2022, duhet të procedojmë në Kuvend edhe buxhetin për këto komuna, pra që

janë me vonesë. Komunitat i kanë dorëzuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve vendimet e kuvendeve komunale në fjalë mbi aprovimin e buxhetit dhe të gjitha dokumentet e nevojshme, duke përfshirë këtu tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3. Kështu të gjitha komunat i kanë respektuar kufijtë buxhetorë", ka thënë Murati.

Kryetari i komisionit, Armend Muja, ka kërkuar që buxheti i shtatë komunave, i miratuar me vonesë, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Kosovës 2022. "Buxheti për Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë, Gjakovë dhe Podujevë për vitin 2022, i aprovuar nga kuvendet komunale, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin për vitin 2022, konstatohet që është miratuar", ka shtuar ai.

Komisioni në mbledhjen e sotme



ka formuar grupin punues lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e

Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit, si dhe grupin punues lidhur me shqyrtimin e

Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Ekonomia shqiptare rritet 8.54 për qind në vitin 2021

Tiranë, 31 mars - Ekonomia shqiptare ka shënuar rritje të fortë në vitin 2021, pas tkurrjes që ka shënuar në vitin 2020 si rrjedhojë e pasojave të pandemisë së Covid-19. Sipas raportit të publikuar të enjten nga Instituti i Statistikave INSTAT, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) në vend u rrit me 8.54

për qind në 2021, duke shënuar nivelin më të lartë që nga viti 2001. Rritja e lartë e ekonomisë lidhet me bazën e ulët të vitit 2020, kur ekonomia u tkurr me 3.96 për qind, e ndikuar kryesisht nga ecuria e dobët në sektorët e industrisë dhe transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor,

të cilat panë edhe rënien e fortë si rrjedhojë e kufizimeve lokale e ndërkombëtare për ta frenuar pandeminë.

Sipas raportit, të gjithë sektorët kanë shënuar rritje të fortë dyshifrore në vitin 2021.

Me vlerësimin e tremujorit të katërt INSTAT jep një vlerësim

paraprak të PBB-së për vitin 2021, i cili mbështetet në vlerësimet tremujore. Sipas INSTAT, rritja në 2021 u ndikua nga të gjithë sektorët, por më e fortë ishte në tregti, transport, akomodim dhe shërbim ushqimor dhe industria përpunuese, nxjerrëse dhe energjia, të cilat ranë më shumë në

vitin 2020.

Zgjerimi i aktivitetit të sektorit të ndërtimit ka vijuar, ndërsa sektori me ecuri më të dobët ishte bujqësia. Ndërkohë, PBB-ka në tremujorin e katërt të vitit 2021 vlerësohet me rritje prej 5.52-përqindësh në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



Bordi i AKP-së aprovoi listën e shitjes të aseteve në likuidim SHAL 55

Prishtinë, 31 mars (ER) - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës

në të cilin ka diskutuar dhe ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të

ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor.

Bordi ka shqyrtuar dhe

aprovuar listën e aseteve në likuidim SHAL 55 për vendosje në tender publik, gjithashtu udhëzoi menaxhmentin që

tarifat për pjesëmarrje në tender të jenë sa më të pranueshme për palët e interesuara.

Vazhimi i Luftës në Ukrainë rrezikon destabilizimin e Perëndimit



Nga Gideon RACHMAN
"Financial Times"

Në aleancën perëndimore ekziston një besim në rritje mbi trajektoren e luftës në Ukrainë.

Ky besim është i justifikuar, por potencialisht i rrezikshëm. Është e dukshme që për Rusinë pushtimi ka shkuar shumë më keq, sesa guxuan të shpresonin shumica e njerëzve në Perëndim.

Aleatët perëndimorë kanë befasuar edhe veten e tyre me forcën, shpejtësinë dhe unitetin e kundërpërgjigjes së tyre, me sanksionet e pashembullta të vendosura ndaj Rusisë, dhe me ndihmën e madhe ushtarake që kanë dhënë për Ukrainën.

Optimizmi i madh në Uashington dhe në pjesë të Evropës, u reflektua qartazi në deklaratën kontroverze të Joe Biden se udhëheqësi rus Vladimir Putin "nuk mund të qëndrojë më në pushtet". Supozohet gjerësisht se presidenti amerikan se ka folur në një mënyrë të pamundur, dhe se ndihmësit e tij u detyruan ta përgënjeshtrojnë me shpejtësi.

Por komentet e tij pasqyrojnë ndjenjën që dominon aktualisht në Uashington, se një formë e "ndryshimit të regjimit" në Rusi është edhe e imagjinueshme edhe e dëshirueshme. Në fakt, pozita e brendshme dhe ajo ndërkombëtare e Putinit, duket shumë me e lëkundur se përpara pushtimit.

Por nga ana tjetër realiteti më pak

i diskutuar, është se lufta paraqet ndërkohë edhe rreziqe politike të mëdha dhe në rritje për qeveritë në Perëndim. Ekziston ende rreziku që Rusia tavazhdojë luftën për shumë muaj, me një numër në rritje të vdekjeve dhe shkatërrimit të infrastrukturës.

Ndërkohë, efektet e shpëputjes së marrëdhënive ekonomike me Moskën, do të fillojnë të bëhen shumë më akute në Evropë, në formën e rritjes së çmimeve, mungesës së energjisë, humbjes së vendeve të punës, dhe ndikimit social gjatë përpjekjes për të menaxhuar deri në 10 milionë refugjatë ukrainas.

Amerika është më pak e ekspozuar ekonomikisht se sa Evropa ndaj këtyre efekteve. Por lufta filloi me inflacionin tashmë në nivele të larta në SHBA, dhe me një popullaritet në rënie të Joe Biden. Tani po rritet çmimi i benzinës, dhe kjo gjë pritet gjithmonë keq nga votuesit amerikanë.

Ndërkohë, faturat e energjisë për konsumatorët dhe bizneset në Evropë, po rriteshin ndjeshëm edhe para luftës. Tani ato do të rriten shumë më tepër. Në Britaninë e Madhe, familjet mund të shohin një rritje prej 50 për qind të faturave të energjisë për muajin prill, e pasuar nga një rritje tjetër prej 50 për qind në muajin pasardhës.

Objektivi i Bashkimit Evropian për ta reduktuar me 2/3 varësinë nga gazi rus deri në fund të këtij viti, cilësohet nga disa ekspertë si një

përgjigje shumë e dobët, pasi kjo do të thotë se Rusia do të vazhdojë të marrë miliarda euro në javë të ardhura nga eksportet e saj.

Por në një konferencë javën e kaluar, tregtarët paralajmëruan se edhe ai reduktim i sasisë së blerjeve, do të jetë shumë i vështirë të arrihet brenda këtij viti. Disa besojnë se mungesa e naftës ruse, mund të çojë në racionimin e karburantit në Evropë gjatë këtij viti.

Edhe çmimet e ushqimeve ka të ngjarë të rriten, duke reflektuar rëndësinë që kanë Ukrainadhe Rusia për tregjet globale të grurit dhe plehrave. Rrjedhimisht, do të rritet numri i evropianëve që i përdorin mensat sociale, apo që do të kërkojnë ndihmë urgjente.

Ndërkohë, në Lindjen e Mesme, ku qeveritë kanë më pak burime për të zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve të ushqimit, mund të ketë një rritje të madhe të urisë. Kjo nga ana tjetër, mund të çojë në një rritje të re të numrit të njerëzve të dëshpëruar që do të përpiqen të migrojnë drejt Evropës.

Qeveritë në Evropë, që tashmë e kanë shumë të vështirë të përballojnë fluksin e miliona ukrainasve, mund të përballen së shpejti me shumë më tepër emigrantë të mundshëm nga Lindja e Mesme dhe Afrika. Përgjigja publike ndaj këtyre zhvillimeve në Evropë dhe SHBA, ka të ngjarë të jetë e paqëndrueshme dhe kontradiktore.

Fokusi aktual mbi Ukrainën në

media ndoshta do të zbehet, pasi lufta e humbet vlerën e saj tronditëse. Deri në vjeshtë, kriza ekonomike mund ta dominojë politikën. Kjo do të sigurojë një terren pjellor për një ringjallje të populistëve si Donald Trump në SHBA, Marine Le Pennë Francë apo Matteo Salvini në Itali, të cilët duhet se kanë qenë në të kaluarën fansa të njohur të Putinit.

Sigurisht, presioni ekonomik ndaj Rusisë do të jetë shumë më i madh. Por Putini drejton një diktaturë. Dhe udhëheqësit e demokracive perëndimore duhet të shqetësohen për votuesit e tyre. Ata e dinë se historikisht shumë pak qeveri mund t'i mbijetojnë stagflacionit dhe krizës shoqëruar të kostos së jetesës.

Ndërsa rritet presioni ekonomik, mund të thyhet edhe uniteti perëndimor aktual, gjë që mund të sjellë presione kontradiktore mbi liderët politikë. Më shumë shkatërrime në Ukrainë, sirrafshimi i Mariupolit, do të shkaktojnë kërkesa të reja për një përgjigje edhe më të ashpër të Perëndimit, deri në ndërhyrjen e drejtpërdrejtë ushtarake në këtë konflikt.

Njëkohësisht, do të ketë një riaktivizim të "atyre që e mirëkuptojnë Putinin": një fraksion i opinionit perëndimor (veçanërisht atij gjerman) që për momentin ka rënë kryesisht në heshtje. Ata do të kërkojnë t'i jepet fund konfliktit, edhe nëse kjo nënkupton tërheqjen e mbështetjes për Ukrainën dhe

bërjen e lëshimeve ndaj Rusisë, që aktualisht duken të papranueshme.

Ky tension ka nisur të shfaqet që tani midis perëndimorëve. Presidenti francez Emmanuel Macron, e ka kritikuar publikisht homologun amerikan Joe Biden, duke u kërkuar liderëve perëndimorë të shmangin retorikën përshkallëzuese, e cila e bën të pamundur rivendosjen e paqes në Ukrainë.

Por Macron mund të jetë duke shpresuar më shumë ssa duhet tek perspektivat e negociatave për paqe. Pavarësisht titujve bombastikë në mediave rreth bisedimeve të paqes në Turqi, të dyja palët mbeten ende shumë larg njëra-tjetrës. Ka pak prova reale se Putini është i përgatitur të pranojë çdo gjë tjetër përveç fitores që i ka premtuar Rusisë.

Një luftë e gjatë do ta shtojë presionin politik dhe ekonomik mbi qeveritë perëndimore. Kërkesa e presidentit amerikan Joe Biden për largimin nga pushteti të Vladimir Putinit, mund të ketë qenë jo-diplomatike.

Por ai ka me siguri të drejtë, kur sugjeron se marrëdhëniet normale midis Rusisë dhe Perëndimit janë të pakonceptueshme, nëse Putini do të vijojë të mbetet në krye të Kremlinit. Ndryshimi i regjimit në Rusi mund të jetë i nevojshëm, edhe për të shmangur trazirat politike në Perëndim.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Sonte Drita - Prizreni 16, nesër derbi Prishtina - Ylli



PRISHTINË, 31 MARS - Xhiroja e 25-të e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë disa ndeshje shumë interesante. Takimi i parë zhvillohet në mes të Dritës dhe Prizrenit 16, ku prizrenasit janë favoritë për të triumfuar, pasi kanë 14 fitore dhe dhjetë humbje, kurse gjilanasit kanë 24 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara. Të shtunën do të zhvillohet një duel interesant në mes të Sigal Prishtinës dhe Prishtinasit kanë 12 fitore e 12

humbje, kurse therandasit 18 fitore e gjashtë humbje. Një sfidë me mjaft interes është ndërmjet finalistëve të Kupës, Pejës dhe Trepçës. Pejanët kanë 15 fitore e nëntë humbje, duke u renditur në vendin e tretë, kurse mitrovicasit kanë 17 fitore e shtatë humbje, duke u renditur në vendin e dytë. Përballje me shumë rëndësi është Bashkimi dhe Rahoveci, që renditen në vendin e shtatë, përkatësisht të gjashtë, me Vreshtarët që kanë dy pikë më shumë se prizrenasit. Bashkimi ka nëntë

fitore e 15 humbje, kurse Rahoveci ka 11 fitore e 13 humbje.

SUPERLIGA - Java 25

Të premten:
19:00 Drita - Prizreni 16

Të shtunën takohen:
19:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:
17:00 Peja - Trepça
19:00 Bashkimi - Rahoveci

SHKURT

Kosova shënon ngritjen më të lartë në renditjen e FIFA-s

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar ngritjen më të lartë ndonjëherë në renditjen e FIFA-s. "Dardanët" e nisën vitin 2022 me këmbë të mbarë duke e mposhtur fillimisht në shtëpi Burkina Fason me rezultat të thellë, 5-0, ndërsa barazuan në ndeshjen e dytë me Zvicrën (1-1). "Dardanët", në fakt, gjenden në vendin e 107, më i miri ndonjëherë për ta. Kosova ishte renditur më së miri deri tash në vendin e 109 në muajin shkurt të këtij viti. Ndërkohë, kombëtarja shqiptare ka pësuar rënie dhe tash gjendet në vendin e 66, me 3.12 pikë më pak se në muajin e kaluar. Kuqezinjtë humbën nga Spanja 1-2 në muajin mars dhe barazuan me Gjeorgjinë, 0-0.

Coker, MVP e sfidave gjysmëfinaleve

Të mërkurën u zhvilluan ndeshjet e para gjysmëfinale të "play-off"-it në Superligën e Femrave, ku fitore shënuan Prishtina dhe Bashkimi ndaj Trepçës, përkatësisht Penzës. Në sfidën mes Penzës dhe Bashkimi u dallua Monique Coker me 11 pikë, 17 kërcime (pesë në sulm dhe 12 në mbrojtje), katër asistime, tre topa të vjedhur dhe dy bllokada. Bashkimi bëri një hap para, ndërsa skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në finale. Ndeshje shumë të mirë zhvilloi edhe Agnesa Rrahmani e Prishtinës në përballjen ndaj Trepçës, me 22 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime.

Darell Davis, më i miri i ndeshjeve të para çerekfinale

Të mërkurën u zhvilluan ndeshjet e para çerekfinale të "play-off"-it në Ligën Unike, ku fituan Prizreni 16 dhe Teuta e Durrësit, duke mundur Rahovecin, përkatësisht Tirana Neptun. Te Prizreni 16 u dallua edhe një herë Darell Davis me 23 pikë, 12 kërcime, nëntë asistime, dy topa të vjedhur dhe dy bllokada, duke pasur indeksin e ndeshjes, 36 apo më të lartën e xhiros. Davis edhe një herë ishte vendimtar për prizrenasit, sidomos në dhjetë minutat e fundit, ku u vendos ndeshja. Ish-basketbollisti i Rahovecit bëri edhe sfidë të jashtëzakonshme, duke qenë ndër lojtarët më të mirë të huaj në Ligën Unike dhe Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Davis për tri pikë nga gjashtë tentime, dy herë ishte i saktë, kurse për dy pikë nga 19 tentime, ishte i saktë tetë herë. Tashmë prizrenasit kanë pesë pikë epërsi ndaj rahovecasve.

Gjysmëfinalët e Kupës: Prishtina - Llapi dhe Drita - Ramiz Sadiku

PRISHTINË, 31 MARS - Në praninë e Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për gjysmëfinalen e Kupës së Kosovës në futboll. Skuadra e Dritës mund të llogaritet

se ishte me fat në short, pasi për kundërshtar në gjysmëfinale e tërhoqi skuadrën e Ramiz Sadikut, e cila garon në Ligën e Parë, ndërsa në përballjen tjetër gjysmëfinale do të luajnë Prishtina dhe Llapi. Ndeshjet

e para do të zhvillohen më 7 prill, derisa ato të kthimit më 13 prill. Fituesi i kësaj gare e përfaqëson Kosovën në Europa Conference League. Vitin e kaluar këtij trofeu iu gëzua skuadra e Llapit.



Messi dhe Neymari largohen nga PSG-ja, vjen Zidane dhe qëndron Mbappe

PARIS, 31 MARS - PSG-ja është një nga skuadrat më të fuqishme në botën e futbollit, por investimet e mëdha nuk është se kanë dhënë frytet e duhura. Parisienët janë eliminuar nga Liga e Kampionëve që në fazën e 1/8-

ve, edhe pse morën verën e kaluar një yll si Lionel Messi. Gazeta "L'Équipe" në Francë së fundmi raporton se klubi i PSG po përgatitet për një revolucion të vërtetë në merkaton e ardhshme. Drejtori sportiv, Leonardo, me shumë mundësi

do të largohet, ndërkohë që për bankinën ëndrra e madhe mbetet Zinedine Zidane, i cilësuar si një nga trajnerët më të mirë në vitet e fundit. Nuk mungojnë as alternativat si Conte dhe Thiago Motta. Revolucionin do t'i prekë edhe

yjet. PSG-ja është gati që të heqë dorë nga Messi dhe Neymari, teksa për ta përflitet për transferim të mundshëm në Amerikë. Klubi do ta ndërtojë skuadrën me një projekt të ri që do të udhëhiqet nga Kylian Mbappe, i cili deri më tani ka



refuzuar që ta rinovojë kontratën. Gjithsesi, asgjë nuk përjashtohet në muajt në vijim.

Rashkaj: Ja risia që pashë në lojën e Gireses krahasuar me atë të Challandesit

PRISHTINË, 31 MARS - Ish-futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Anel Rashkaj, e ka cilësuar si një paraqitje dinjitoze atë të Kosovës kundër Zvicrës në miqësoren e zhvilluar të martën në Cyrih. Ai ka thënë se kjo ndeshje ishte shumë e rëndësishme për ta parë nivelin e skuadrës si dhe impaktin e parë të trajnerit të ri Alain Giresse. "Mendoj se ka qenë një ndeshje e rëndësishme për ne dhe për trajnerin ta kemi një kundërshtar të fortë që të testojmë ekipin, po ashtu për tifozët që jetojnë në Zvicër që ta kenë mundësinë ta shohin ekipin tonë nga afër. Mendoj se ka qenë një paraqitje e mirë si në aspektin individual, po ashtu edhe në aspektin ekipor", ka thënë Rashkaj. Në lidhje me atë nëse ai ka parë ndonjë ndryshim në lojën e Kosovës nën urdhrat e trajnerit të ri Alain Giresse krahasuar me atë të aplikuar nga ish-trajneri Bernard Challandes, Rashkaj ka thënë për "KosovaPress" se ka vërejtur një ndryshim thelbësor.



"Po, kam parë disa risi që më kanë pëlqyer në aspektin taktik. Një prej tyre ka qenë disiplina në anën defensive dhe, po ashtu, loja me kundërsulme ku unë mendoj se është arma kryesore e ekipit tonë. Unë mendoj se nuk jemi ende aty të aplikojmë lojë 'tiki-taka'. Disiplina defensive dhe kundërsulmet mendoj se do të jenë çelësi kryesor për sukses të paktën për momentin. Besoj se

kemi hyrë tani me një entuziazëm të ri me trajner të ri, po ashtu forma e mirë e lojtarëve në Evropë jep sinjale të mira për ndeshjet në qershor", ka shtruar Rashkaj. Ndryshe, Kosova në dy ndeshjet e para me trajnerin e ri mori një fitore, duke e mposhtur Burkina Fason me rezultat 5-0 dhe barazoi me Zvicrën me rezultat 1-1.

Miami dhe Phoenixi kryesojnë konferencat, fitojnë edhe Dallasi e Denveri

BOSTON, 31 MARS - Miami mbron kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 106-98 arritur në fushën e rivalëve të Bostonit, takim që u komandua nga Miami, ku u dalluan Butleri me 24 pikë e Lowry me 23, duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Brownit për Celticsib. Në Perëndim në vendin e parë qëndron i vetëm dhe i shkëputur nga rivalët Phoenixi, që e mposhti me rezultat 107-103



Golden State. Të gjithë titullarët e Phoenixit realizuan mbi 10 pikë (Bridges e Booker nga 22 pikë secili), ndërsa 38 pikët e Pooles për Warriorsin mbetën për statistikë. Jashtë fushës fiton edhe Dallasi, që falë 35 pikëve e 13 asistimeve të Luka Donçiqit që e mundi me

shifrat 120-112 Clevelandin. Ndërsa Denveri mposhti me rezultat 125-118 Indianan, takim ku u dallua Nikola Jokiç, me 37 pikë e 13 rebounde. Fitore në sekondat e fundit korri Memphis, që e mundi me rezultat 112-111 San Antonion (Jones 25 pikë).

REZULTATET

Cleveland - Dallas	112-120
Indiana - Denver	118-125
Washington - Orlando	127-110
Boston - Miami	98-106
New York - Charlotte	114-125
Toronto - Minnesota	125-102
Houston - Sacramento	118-121
Oklahoma - Atlanta	118-136
San Antonio - Memphis	111-112
Golden State - Phoenix	103-107
Portland - New Orleans	107-117

Kante e kishte refuzuar ofertën e PSG-së

N'Golo Kante e ka refuzuar ofertën e Paris Saint-Germainit për t'iu bashkuar në afatin kalimtar të janarit. "Le Parisien" raporton se PSG-ja

është përpjekur të bindte 31-vjeçarin të nënshkruante për klubin në fund të afatit kalimtar të janarit. Megjithatë, Kante është i lumtur me jetën

në Londër dhe te Chelsea, dhe nuk kishte ndër mend të largohej në mes të sezonit. Kante, pas këtij sezoni, ka edhe një vit tjetër të mbetur në

kontratën e tij, e cila skadon në verën e vitit 2023. Një lëvizje verën e ardhshme mund të jetë e mundur, veçanërisht nëse ai nuk e rinovon marrëveshjen e

tij. Në këtë verë mundësitë janë të pakta dhe ndodh vetëm nëse Chelsea vendos të arkëtojë para për të siguruar një zëvendësues më të ri.

SHKURT

Idrizi rinovon kontratën me Schalcken

Blendi Idrizi ka firmosur kontratë të re me skuadrën e Schalckes. Mesfushori i kombëtares së Kosovës, Blendi Idrizi, ka arritur marrëveshje me skuadrën e njohur gjermane, Schalke 04. Schalke njofton përmes faqes zyrtare se Idrizi ka firmosur për qëndrim deri në vitin 2024. Kontrata paraprahe e Idrizit ishte deri në vitin 2023, por lojtari ka shtuar edhe një vit.

Unitedi 'blindon' Fernandesin

Mesfushori Bruno Fernandes dhe Manchester Unitedi do ta zgjatën bashkëpunimin e tyre deri më 30 qershor 2027. Eksperti i merkatos, Fabrizio Romano, shkruan se ka mbetur vetëm firma dhe njoftimi zyrtar. Mesfushori portugez, i blerë për 63 milionë euro nga Sporting Lisbone, ka kontratë deri më 30 qershor 2025. Pavarësisht kësaj, Unitedi ka nxituar ta blidojë 27-vjeçarin, i cili ka qenë një nga lojtarët kryesorë të skuadrës që në momentin që u ble.

Marquezi mungon në Çmimin e Madh të Argjentinës

Të dielën Moto GP do ta zhvillojë Çmimin e Madh të Argjentinës, por ashtu sikurse pritej, në këtë ngjarje nuk do të marrë pjesë Marc Marquez. Lajmin e ka dhënë vetë Honda, që bën të ditur se piloti ka përmirësime pas problemit me diplopinë, por nuk është gati ende për të zbritur në pistë. "Marquezi ka shfaqur shenja të dukshme përmirësimi në nervin e katërt të syrit të djathtë, të cilin e dëmtoi gjatë rrëzimit në Indonezi. Por piloti ende nuk është shëruar plotësisht, kështu që duhet t'i vazhdojë terapitë e trajtimit", shkruhet në deklaratën e Hondës. Kjo është hera e tretë që Marquez vuan nga diplopia, problem që i shkakton shikim dopio.

Allegri: Realin e refuzova për Juventusin

Trajneri aktual i Juventusit, Massimiliano Allegri, para derbit me Interin ka zbuluar se e ka refuzuar ofertën e Real Madridit pasi mori ofertë nga "Zonja e Vjetër". "Para se të rikthehesha te Juventus kisha nënshkruar një marrëveshje me Real Madridin. Pastaj në mëngjes telefonova presidentin Perez dhe i thashë: Nuk do të vij atje, sepse kam zgjedhur Juventusin. Ai më falënderoi. Që kur më thirri Juventus në maj, nuk kam pasur asnjë dyshim. Në nivel profesional do të ishte kulmi i një rruge, sepse pas Milanit, Juventus dhe pastaj Real Madridi. Por në jetë nuk mund të kesh gjithmonë gjithçka dhe unë jam vërtet i lumtur dhe krenar që kam drejtuar Milanin për katër vjet dhe tani ndodhem në vitin e gjashtë të një klubi si Juventus. Real Madridit i thashë jo dy herë", ka thënë Allegri.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 2537 të datës 10.12.2021, Ndryshimit të Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 93 të datës 27.01.2022, nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 33 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si dhe Vendimit të Auditorës të Përgjithshme me Nr. 512 të datës 29.03.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për dizajnim të raporteve dhe publikime
Numri i referencës:	RZDRP/ZKA/08-04/22
Grada:	ZKA-B6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimi i dizajneve dhe punëve të tjera grafike/vizuale për krijimin e identitetit, konceptit dhe përquarjes së mesazhit apo simbolikës së raporteve të auditimit sipas përmbajtjes së tyre.
- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet në rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikat e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte për broshura, prezantime, flyer-a, fletpalosje etj ;
- Asiston me realizimin dhe përgatitjen e videove dhe fotografive;
- Kryen edhe detyra të tjera, të ndërlidhura me dizajnin grafik dhe që paraqiten sipas nevojave dhe rasteve të caktuara.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik ose të ngjashme;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 01.04.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 16.04.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu, br. 2537 datuma 10.12.2021 i Izmenu Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu br. 93 datuma 27.01.2022, članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 33 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 512 datuma 29.03.2022 Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Položaj:	Službenik za dizajniranje izveštaja i publikacija
Broj reference:	RZDRP/ZKA/08-04/22
Nivo:	ZKA-B6
Broj radnih mesta:	Jedno (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada dizajna i drugih grafičkih/vizuelnih radova za kreiranje identiteta, koncepta i prenosa poruke ili simbolike revizorskih izveštaja prema njihovom sadržaju.
- Priprema projekte dizajna, od ideje do distribucije;
- Definiše slike, fontove i formate pomoću softvera za grafički dizajn;
- Istražuje ideje za predstavljanje koncepta i reklamiranje proizvoda/usluga na društvenim mrežama, veb stranicama, televiziji, novinama, itd.;
- Koristi tehnike tipografije;
- Kreira različite verzije dizajna, logotipa, koncepta za brošure, prezentacije, flajere, letke itd.;
- Pomaže u realizaciji i pripremi video zapisa i fotografija;
- Izvrši i druge zadatke, vezane za grafički dizajn i predstavljene prema specifičnim potrebama i slučajevima.
- Obavlja i druge zadatke po naređenju direktora departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma u oblasti grafičkog dizajna ili slično;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz relevantne oblasti

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 01.04.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 16.04.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, 01 prill 2022

NJOFTIM PËR ZGJATJE TË KONKURISIT

Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 15 (Dorëzimi i Aplikacioneve) të Rregullores nr. 04/2015 për procedurat e rekrutimit, emërimit dhe periudhës provuese të stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përkatësisht për shkak të mos arritjes së numrit të balancuar të kandidatëve, sipas përfaqësimit etnik, gjegjësisht përfshirjes së ultë të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, ju njoftojmë se afati për pranimin e aplikacioneve për pozitën: **2. Zyrtar për Multimedia dhe Ueb faqe** dhe **3. Përkthyes nga shqipja në anglisht e serbisht dhe anasjelltas**, zgjatet edhe për 7 ditë kalendarike, deri më datën më datën 07 prill 2022, ora 16.00.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 7/04/2022, deri në ora 16.00.

Gjykata Kushtetuese inkurajon veçanërisht pjesëtarët e Komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës që të aplikojnë për pozitën e rishpallura përmes Konkursit të zgjatur.

Aplikuesit të cilët kanë dorëzuar aplikacionet për punësim në 15 ditët e para të konkursit nuk kanë nevojë ta përsërisin aplikimin.

Perandori Justinian 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +381 (0)38 606 162; Fax: +381 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 31.03.2022 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-22-03

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e hapësirave
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes:	31.03.2022
Sqarimi:	deri me 11.04.2022
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 11.04.2022 Behet në e-Mail: poshtë shkëputur ose në zyrën e Divizionit të shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	13.04.2022 në 10:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, 01 april 2022

OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE KONKURSA

U skladu sa stavom 3 člana 15 (Podnošenje prijave) Uredbe br. 04/2015 o procedurama za regrutovanje, imenovanje i period probnog rada osoblja u Ustavnom Sudu Republike Kosovo, odnosno zbog neuspeha da se postigne izbalansiran broj kandidata, prema etničkoj zastupljenosti, odnosno malog učesća pripadnika ne-većinske zajednice, Obaveštavamo vas da se rok za prijem prijave za radna mesta:

- Službenik za multimediju i veb sajtove i
- Prevodilac sa albanskog na engleski i srpski jezik i obrnuto, produžava za još 7 kalendarskih dana, do 7 aprila 2022. u 16.00 časova.

Poslednji rok za prijem prijave je 07.04.2022.godine do 16.00 časova.

Ustavni Sud posebno ohrabruje pripadnike nevećinskih zajednica u Republici Kosovo da se prijave za ponovo oglašena radna mesta putem produženog konkursa.

Kandidati koji su podneli prijave za zapošljavanje u prvih 15 dana konkursa nemaju potrebu da ponavljaju prijavu.

Perandori Justinian 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +381 (0)38 606 162; Fax: +381 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Intering" Sh.p.k Obiliq, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e centralit solar fotovoltaik me kapacitet 5.62 MW në Dobrushë në Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.04.2022 në ora 10:00 në fshatin Dobrushë, Komuna Istog, tek Bau-Haus, salla kati 2-të Rr. "Lidhja e Pejes" Nr.480 Dobrushë, Istog 31000, do të organizohet debat publik nga Kompania "Intering" Sh.p.k Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e centralit solar fotovoltaik me kapacitet 5.62 MW në Dobrushë në Istog.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Intering" Sh.p.k Obiliq për ndërtimin e centralit solar fotovoltaik me kapacitet 5.62 MW në Dobrushë në Istog.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "NEW WAVE" SHPK me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit 811512517 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamosve klijente da Tvrtka "NEW WAVE" SHPK u Prizren deneo odluku da ugasi biznis po br.registara 811512517 i ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije.

Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "NEW WAVE" SHPK based in Prizren has taken the decision to terminate the bussines with registration number 811512517 and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reporst in this company are notified to be presented with in 30 days from the date publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Jeta-3M" shpall të humbur certifikatën e biznesit me nrb: 70297781.
- ▶ Selim Rami shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- ▶ Branislav Popovic shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Albert Jahdauti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.
- ▶ Arben Jahdauti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.
- ▶ Forian Fanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Fize Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.
- ▶ Binak Qestaj nga Juniku shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës.
- ▶ Ideal Hilmi Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.P. "Gjon Nikoll Kazazi" Teknologji e PC-ve.
- ▶ Xhevat Abdullahi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nëna Terezë" Vranidoll Prishtinë nga kl. I deri VIII .
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

